

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE PËR VITIN 2020**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasje të trefishtë ndërgjegjësuëse, parandaluese dhe ndëshkuëse;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura, për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2020 të Komisionit Europian në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektorati, si dhe mbështetjen e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre,

**Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2020 në drejtim të:**

- Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe në veçanti në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit të datës 28.5.2020 “Për vlerësimin

e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2019”.

- Zbulimit të rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave private, duke administruar një numër total prej 3769 deklaratash të interesave private, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave, që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private të 762 subjekteve deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 33 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 72 raste referimesh penale.

- Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë nëpërmjet angazhimit të pjesës më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale dhe bashkëpunimit ndër-institucional me organet e rivlerësimit kalimtar, duke përmbushur detyrat funksionale brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në fuqi të lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përfunduar dhe dorëzuar dokumentacionin e plotë së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- Konsolidimit të marrëdhënieve me organet e reja të sistemit të drejtësisë, si: KLGJ, KLP, ILD dhe SPAK, kryesisht në verifikimin brenda afateve ligjore të deklaratave të pasurive dhe interesave private për kandidatët për pozicione të ndryshme të këtyre organeve.

- Administrimit dhe analizimit të 386 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 149 i përkasin sektorit publik dhe 237 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në dispozitat e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Megjithatë, nga të dhënat rezulton se 222 njësi përgjegjëse, ku 19 i përkasin sektorit privat, nuk kanë paraqitur raportet vjetore në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22 të ligjit të sipërpërmendur.

- Regjistrimit dhe trajtimit në zbatim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, të 9 rasteve sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, duke aplikuar në përfundim të hetimit administrativ 1 masë administrative “gjobë” ndaj një titullari institucioni për shkelje të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe zgjidhjen e një rasti me konflikt interesi.

- Vijimit të procesit të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private me angazhimin maksimal nga ana e institucionit për vendosjen në funksionalitet të plotë brenda vitit 2021.

- Bashkëpunimit me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në kuadër të projektit “Fuqizimi i pushtetit vendor për zbatimin e ligjit për sinjalizimin”, duke marrë pjesë dhe duke dhënë ekspertizën e nevojshme në 10 sesione trajnuese dhe trajnimin e 163 anëtarë të njësive përgjegjëse dhe nëpunës pranë bashkive.

- Angazhimit të mëtijshëm për përmirësimin e kanaleve të raportimit të sinjalizimeve dhe mekanizmat e mbrojtjes për sinjalizuesit nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI) të financuar nga BE-ja.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet kryesore brenda vendit, që kanë fushë të përgjegjësisë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe parandalimin e pastrimit të parave.

- Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore 6182 kërkesa të publikut për publikimin e deklaratave të interesave private.

## **Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021 të vazhdojë punën në këto drejtime:**

- Të forcojë më tej bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet e rivlerësimit dhe ONM-në deri në përfundim të procesit të rivlerësimit nga këto organe, si dhe të vijojë mbështetjen e proceseve për verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë në një kohë sa më të shpejtë.

- Të angazhohet në përputhje me rekomandimet e progresraportit të KE-së dhe GRECO-s për përfundimin dhe vënien në funksionalitet të plotë brenda vitit 2021 të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, që do të kontribuojë drejtpërsëdrejti në forcimin e besueshmërisë së institucionit.

- Të intensifikojë trajnimet e stafit në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative dhe investiguese, për të qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit.

- Të vijojë angazhimin në drejtim të rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe privat në kuadër të zbatimit të ligjit për sinjalizimin, me qëllim ndërgjegjësimin për raportimin e praktikave të dyshuara të korrupsionit, përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të anëtarëve të këtyre njësive. Në këtë drejtim t'i jepet prioritet bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit, në adresimin e nevojave të tyre për trajnim e ndërgjegjësim në përputhje me rekomandimet e lëna nga GRECO.

- Të forcohet bashkëpunimi mes ILDKPKI-së dhe SPAK-ut për të përmirësuar në mënyrë të efektshme ndjekjen e çështjeve të adresuara në prokurori nga ILDKPKI-ja në kuadër të refuzimit për deklarimin, mosdeklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, veçanërisht për persona të cilëve u janë ngarkuar funksione të larta ekzekutive.

- Bashkëpunimin e mëtejshëm dhe dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime për zbatimin e duhur të kuadrit ligjor për parandalimin e konfliktit të interesave, veçanërisht për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse në evidentimin e deklarimeve rast pas rasti, të cilat nga raportet e organizmave ndërkombëtarë nuk zbatohen.

Miratuar në datën 24.6.2021